

LIGJ
Nr.10 435, datë 23.6.2011

PËR SHËRBIMIN E KËRKIM-SHPËTIMIT (SAR) NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NË RAST AKSIDENTESH AJRORE DHE DETARE¹

(Ndryshuar me ligjin nr. 110/2024, datë 31.10.2024)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

(Ndryshuar togfjalësh dhe shtuar shkurtesa me ligjin nr. 110/2024, datë 31.10.2024)

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i autoriteteve, rregullave dhe procedurave për organizimin e shërbimit të kërkim-shpëtimit SAR, me qëllim shpëtimin e jetës njerëzore, duke përdorur me efektivitet të gjitha burimet e mundshme në kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit, në raste aksidentesh të ndryshme ajrore, detare dhe në ujërat e brendshme, duke ndërhyrë, kërkuar, gjetur dhe shpëtuar persona të humbur ose të zhdukur.

Neni 2

Fusha e zbatimit të ligjit

Ky ligj zbatohet në hapësirën tokësore, detare e në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë, si dhe në zonat e përgjegjësisë, të ndara sipas marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe, të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë.

Neni 3

Përkufizime

(Ndryshuar me ligjin nr. 110/2024, datë 31.10.2024)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “ARCC” është Qendra Ajrore e Koordinim-Shpëtimit, përgjegjëse për operacionet aeronautike të kërkimit e të shpëtimit.
- b) “Emergjenca SAR” është situata e krijuar në rastet e aksidenteve të ndryshme ajrore dhe detare që nënkupton, sipas rastit, një fazë emergjence SAR.

¹ Ndryshuar titulli i ligjit me ligjin nr. 110/2024, datë 31.10.2024, botuar në F.Z nr. 199, datë 26.11.2024

c) “Faza e emergjencës SAR” është situata që tregon, sipas rastit, fazë pasigurie, alarmi ose rreziku të vendosura e të pranuar nga autoritetet ndërkombëtare detare dhe ajrore të ICAO/IMO, nëpër të cilat kalon klasifikimi i incidentit SAR dhe përcaktimi i veprimeve që do të ndërmerren.

ç) “Faza e paqartësisë/pasigurisë” është një situatë kur ekziston paqartësia për sigurinë e mjetit ajror/detar dhe të personave në bordin e tij.

d) “Faza e alarmit” është një situatë kur mendohet se mjeti ajror/detar dhe personat në bordin e tij ose njësia tokësore janë të pasigurta.

dh) “Faza e rrezikut” është situata në të cilën ekziston një bindje e arsyeshme dhe është e sigurt se personi/personat apo mjeti ajror/detar dhe personat në bordin e tij gjenden në rrezik serioz ose kanë nevojë për ndihmë të menjëhershme.

e) “ICAO” është Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil.

ë) “IMO” është Organizata Ndërkombëtare Detare.

f) “JRCC” është Qendra e Përbashkët e Koordinim-Shpëtimit, përgjegjëse për operacionet aeronautike dhe detare të kërkimit e të shpëtimit.

g) “KKAKSH” është Koordinatori Kombëtar Ajror i Kërkimit e Shpëtimit.

gj) “KKDKSH” është Koordinatori Kombëtar Detar i Kërkimit e Shpëtimit.

h) “Mjet detar SAR” është mjeti detar i destinuar për operacione SAR, me pajisje dhe personel të nevojshëm për operacionet detare SAR.

i) “Mjet ajror SAR” është mjeti ajror i konfiguruar për misione kërkim-shpëtimi.

j) “MRCC” është Qendra Detare e Koordinim-Shpëtimit, përgjegjëse për operacionet detare të kërkimit e të shpëtimit.

k) “Njësi shpëtimi SAR” janë njësitë e përbëra nga personel i stërvitur e i kompletuar me mjetet dhe pajisjet e përshtatshme për kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit.

l) “Operacione ndërhyrjeje SAR” janë veprimet për shpëtimin e jetës së njerëzve, në raste aksidentesh të ndryshme, ajrore, detare edhe në ujërat e brendshme.

ll) “Rajoni i kërkim-shpëtimit SAR” është një zonë e përcaktuar brenda së cilës sigurohen shërbimet e kërkim-shpëtimit.

m) “RCC” është Qendra e Koordinimit të Shpëtimit, njësi përgjegjëse e organizimit të shërbimeve të kërkim-shpëtimit dhe për koordinimin e kryerjes së operacioneve të kërkimit e të shpëtimit brenda një rajoni kërkimi dhe shpëtimi.

n) “SAR” është shërbimi i kërkim-shpëtimit, në raste aksidentesh të ndryshme, ajrore, detare dhe në ujërat e brendshme, që nënkupton strukturat, sistemet e vrojtimit, personelin dhe mjetet e procedurat për kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit.

nj) “Subjekte private” janë subjektet e përcaktuara në nenin 26 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KREU II

ORGANIZIMI, STRUKTURA, PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT KRYESORE TË SHËRBIMIT TË KËRKIM-SHPËTIMIT

Neni 4

Organizimi i shërbimit të kërkim-shpëtimit

(Ndryshuar pikat 2, 3 dhe 4 me ligjin nr. 110/2024, datë 31.10.2024)

1. Shërbimi i kërkim-shpëtimit organizohet në nivel kombëtar.

2. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura është Koordinator Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit (KKKSH) në Republikën e Shqipërisë. KKKSH-ja drejton dhe koordinon operacionet e kërkim-shpëtimit nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit, e cila luan dhe rolin e Qendrës së Përbashkët të Koordinim-Shpëtimit (JRCC).

3. Komandanti i Forcës Ajrore të Republikës së Shqipërisë është Koordinator Kombëtar Ajror i Kërkim-Shpëtimit (KKAKSH). KKAKSH-ja drejton dhe koordinon operacionet nëpërmjet Qendrës Ajrore të Kërkim-Shpëtimit (QAJKSH), e cila kryen dhe rolin e Qendrës Ajrore të Koordinimit të Shpëtimit (ARCC).

4. Komandanti i Forcës Detare të Republikës së Shqipërisë është Koordinator Kombëtar Detar i Kërkimit-Shpëtimit (KKDKSH). KKDKSH-ja drejton dhe koordinon operacionet nëpërmjet Qendrës Detare të Kërkim-Shpëtimit (QKDKSH), e cila kryen edhe rolin e Qendrës Detare të Koordinimit të Shpëtimit (MRCC).

Neni 4/1

Komiteti Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit

(Shtuar me ligjin nr. 110/2024, datë 31.10.2024)

1. Në Ministrinë e Mbrojtjes ngrihet dhe funksionon Komiteti Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit, i cili është organ i përhershëm dhe ka përgjegjësi për hartimin e politikave e të strategjive në fushën e kërkim-shpëtimit SAR.

2. Përbërja dhe detyrat e Komitetit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me propozimin e ministrit të Mbrojtjes.

Neni 4/2

Funksionet mbikëqyrëse të shërbimit të kërkim-shpëtimit

(Shtuar me ligjin nr. 110/2024, datë 31.10.2024)

1. Autoriteti i Aviacionit Civil ngarkohet për mbikëqyrjen e shërbimit të kërkimit dhe shpëtimit për sa u takon funksioneve të ofrimit të shërbimit SAR, në situata emergjence të avionëve apo personave përkatës në bord të avionit.

2. Për të siguruar ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse, drejtori ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil ushtron të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil.

3. Për të siguruar ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse, inspektorët e Autoritetit të Aviacionit Civil pajisen me kredenciale nga drejtori ekzekutiv, në përputhje me parashikimet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil.

Neni 5

Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit

(Ndryshuar togfjalësh në pikën 1, shtuar pika 4 me ligjin nr. 110/2024, datë 31.10.2024)

1. Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit është person juridik publik, në varësi të Ministrit të Mbrojtjes, dhe ka si mision menaxhimin dhe koordinimin në nivel kombëtar të operacioneve të kërkim-shpëtimit në hapësirën tokësore, detare dhe ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë, në raste aksidentesh ajrore dhe detare.

2. Organizimi dhe funksionimi i Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit,

bashkëpunimi me institucionet dhe strukturat e tjera shtetërore, si dhe mënyra dhe procedurat e operimit të sistemit, duke përfshirë edhe linjën e komandimit e kontrollit me koordinatorët kombëtarë të ajrit e detit për ofrimin e shërbimit të kërkimit e shpëtimit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Struktura dhe organika e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

4. Standardet për shërbimin e kërkim-shpëtimit, në përputhje me aneksin 12 të Konventës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, miratohen me urdhër të përbashkët të ministrit të Mbrojtjes dhe të ministrit përgjegjës për transportin.

Neni 6

Përgjegjësitë

1. Organet shtetërore, të përcaktuara në këtë ligj, janë përgjegjëse për të dhënë ndihmë në operacionet e kërkim-shpëtimit.

2. Institucionet e tjera shtetërore si dhe subjektet private, sa herë u kërkohet nga Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit, janë të detyruara të ofrojnë ndihmën e tyre në njerëz dhe mjete.

3. Përdorimi i mjeteve të subjekteve private, për qëllime të kërkim-shpëtimit, kompensohet në masën dhe sipas procedurës së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Çdo mjet ajror/detar, si dhe çdo shtetas shqiptar, në përputhje me mundësitë reale, ka për detyrë të lajmërojë për çdo aksident të vërtetuar dhe të kontribuojë në dhënien e ndihmës.

Neni 7

Detyrat e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit

(Ndryshuar emërtim, shtuar fjalë në shkronjën “c” dhe “e” të pikës 1 me ligjin nr. 110/2024, datë 31.10.2024)

1. Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit, në zbatim të këtij ligji, kryen edhe rolin e Qendrës së Përbashkët të Koordinimit të Shpëtimit (JRCC), si dhe ka këto detyra kryesore:

a) siguron koordinimin e përgjithshëm të operacioneve të shërbimit të kërkim-shpëtimit dhe mban kontakte të drejtpërdrejta me shërbimet homologe të shteteve të tjera;

b) lokalizon mjetet ajrore e detare dhe personat në bordin e tyre, që janë në rrezik dhe/ose të aksidentuar në rajonin e kërkim-shpëtimit të Republikës së Shqipërisë dhe drejton për në vendin e aksidentuar, sa më shpejt të jetë e mundur, njësitë e nevojshme të shpëtimit;

c) drejton dhe koordinon operacionet e shpëtimit të jetës njerëzore, duke përcaktuar përparësitë e ndërhyrjeve;

ç) siguron ndihmë për mjetet ajrore e detare dhe për personat në rrezik në bordin e tyre në zonën e përgjegjësisë, në përputhje me mundësitë reale;

d) në rast hetimesh, bashkëpunon dhe shkëmben të dhënat e mbledhura me autoritetet kompetente kombëtare e ndërkombëtare;

dh) planifikon dhe specifikon detyrimet e nevojat për përdorim sa më racional të burimeve e të mjeteve;

e) bashkëpunon në fushën e shërbimit të kërkim-shpëtimit, sipas ICAO-së, IMO-së, me shërbimet homologe të vendeve fqinje, me të cilat janë nënshkruar marrëveshje në fushën e kërkim-shpëtimit;

ë) kur e gjykon të arsyeshme, njofton menjëherë strukturat e Ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë, Ministrisë së Mbrojtjes, ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, ministrisë përgjegjëse për transportin, ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe pyjet dhe strukturat e tjera publike, për t'u ardhur në ndihmë në rast aksidentesh.

2. Kompetencat e detajuara të Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit dhe Koordinatorit Kombëtar për Kërkim-Shpëtimin përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU III

DETYRAT E INSTITUCIONEVE QENDRORE PËR FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË KËRKIM-SHPËTIMIT

Neni 8

Këshilli i Ministrave

(Shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 110/2024, datë 31.10.2024)

1. Këshilli i Ministrave miraton “Planin kombëtar për shërbimin e kërkim-shpëtimit”, të bashkëpropozuar nga Ministria e Mbrojtjes, ministria përgjegjëse për shëndetësinë, Ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë, ministria përgjegjëse për transportin dhe ministria përgjegjëse për mjedisin dhe pyjet.

2. Programet për pajisjen dhe modernizimin e shërbimit të kërkim-shpëtimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

Neni 9

Ministri i Mbrojtjes

Ministri i Mbrojtjes është përgjegjës për administrimin e përgjithshëm të shërbimit të kërkim-shpëtimit e zbatimin e politikave në këtë fushë, si dhe kryen këto detyra:

a) nënshkruan marrëveshje në përputhje me konventat ndërkombëtare, në fushën e kërkim-shpëtimit, në të cilat aderon Republika e Shqipërisë;

b) nënshkruan marrëveshje me vendet fqinje, për kushtet e hyrjes së njërive të kërkim-shpëtimit në hapësirën ajrore, detare, ujërat territoriale dhe territorin e vendeve respektive;

c) miraton tabelën e organizimit dhe pajisjeve të strukturave operacionale të shërbimit të kërkim-shpëtimit;

ç) miraton rregullore, udhëzime dhe manuale për funksionimin e strukturave operacionale të shërbimit të kërkim-shpëtimit;

d) ndjek zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara me institucionet shtetërore dhe subjektet private në fushën e shërbimit të kërkim-shpëtimit.

Neni 10

Ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë

Ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë, në zbatim të këtij ligji, kryen këto detyra:

a) mbështet, me kapacitetet e saj, operacionet e kërkim-shpëtimit;

b) informon menjëherë strukturat operacionale të kërkim-shpëtimit, në rastet e aksidenteve ajrore, detare, katastrofave dhe fatkeqësive të ndryshme;

c) siguron ruajtjen e rajonit të aksidentit, sipas kërkesës së Qendrës Kombëtare të

Kërkim-Shpëtim;

- ç) siguron qarkullimin rrugor, pa pengesa, të strukturave operacionale të kërkim-shpëtimit për në rajonin e kërkimit;
- d) identifikon personat që japin informacion të rremë;
- dh) kontribuon, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të saj, për identifikimin e viktimave;
- e) bashkërendon veprimet me strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes.

Neni 11

Ministria përgjegjëse për transportin

Ministria përgjegjëse për transportin, përveç detyrimeve që rrjedhin nga akte të tjera ligjore a nënligjore, në zbatim të këtij ligji, kryen edhe këto detyra:

- a) mbështet, me kapacitetet e saj, operacionet e kërkim-shpëtimit;
- b) informon menjëherë strukturat operacionale të kërkim-shpëtimit, për pozicionin, kursin, shpejtësinë dhe sinjalet e thirrjes së avionëve/anijeve në rrezik, brenda rajonit kombëtar të kërkim-shpëtimit;
- c) transmeton dhe ndërhyr menjëherë tek avionët/anijet, që ndodhen në afërsi të incidentit, për dhënie ndihme, duke marrë përgjegjësitë e përcaktuara në konventat ndërkombëtare të pranura me ligj;
- ç) kufizon ose ndalon, përkohësisht, fluturimin dhe lundrimin në të gjithë territorin e vendit ose në një pjesë të tij, kur i kërkohet nga strukturat operacionale të kërkim-shpëtimit, gjatë periudhës së emergjencës.

Neni 12

Ministria përgjegjëse për mjedisin dhe pyjet

(Shfuqizuar shkronja "b" dhe "c", hequr fjalë në shkronjën "ç" me ligjin nr. 110/2024, datë 31.10.2024)

Ministria përgjegjëse për mjedisin, pyjet, në zbatim të këtij ligji, kryen këto detyra:

- a) mbështet, me kapacitetet e saj, operacionet e kërkim-shpëtimit;
- b) shfuqizuar;
- c) shfuqizuar;
- ç) nëpërmjet rrjetit të agjencive rajonale të mjedisit identifikon shkallën e ndotjes dhe rezultatet i bën publike, kur incidenti shoqërohet me ndotje të mjedisit (ajrit, ujërave, tokës);
- d) merr përgjegjësitë ligjore, që vijnë si rrjedhim i aderimit në konventat ndërkombëtare, kur shkalla e ndotjes është e lartë dhe rrezikon ndotjen e ujërave ndërkufitare.

Neni 12/1

Ministria përgjegjëse për shëndetësinë

(Shtuar me ligjin nr. 110/2024, datë 31.10.2024)

Ministria përgjegjëse për shëndetësinë, përveç detyrimeve që rrjedhin nga akte të tjera ligjore, nënligjore, në zbatim të këtij ligji kryen edhe këto detyra:

- a) mbështet me kapacitetet e saj operacionet e kërkim-shpëtimit;
- b) bashkërendon veprimet me strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes;
- c) kontribuon nëpërmjet strukturave përgjegjëse të saj për ndihmën e parë shëndetësore dhe transportin e të plagosurve.

KREU IV
PROCEDURAT E LEJIMIT TË HYRJES SË MJETEVE DHE PERSONELIT TË HUAJ
TË KËRKIM-SHPËTIMIT DHE TË PJESËMARRJES SË NJËSIVE SHQIPTARE
“SAR” NË OPERACIONE KËRKIM-SHPËTIMI JASHTË VENDIT

Neni 13

(Ndryshuar pikat 1 dhe 2 me ligjin nr. 110/2024, datë 31.10.2024)

1. Për vendet e huaja me të cilat është lidhur marrëveshje, leja për hyrjen dhe daljen e mjeteve ajrore, lundruese e të mjeteve të njësive tokësore të shërbimit të kërkim-shpëtimit, me mision kërkim-shpëtimit, pas kërkesës së autoriteteve kompetente, jepet nga Koordinatori Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit.

2. Për vendet e huaja me të cilat nuk është lidhur marrëveshje, leja për hyrjen dhe daljen jashtë vendit të mjeteve ajrore, lundruese e të mjeteve të njësive tokësore të shërbimit të kërkim-shpëtimit, me mision kërkim-shpëtimit, pas kërkesës për ndërhyrje të autoriteteve kompetente, jepet nga ministri i Mbrojtjes.

3. Në të dyja rastet operacionet e kërkim-shpëtimit drejtohen nga strukturat operacionale të kërkim-shpëtimit të vendeve ku kryhen misionet e kërkim-shpëtimit.

KREU V
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 14

Kundërvajtjet administrative

1. Mosrespektimi i detyrimeve, që përcakton pika 2 e nenit 6 të këtij ligji, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 150 000 lekë.

2. Gjoba vendoset nga Kryetari i Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit.

Neni 15

E drejta për ankim

1. Subjektet, të cilat gjobiten sipas nenit 14 të këtij ligji, kanë të drejtën e ankimit, në rrugë administrative, te Ministri i Mbrojtjes, brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

2. Pas shterimit të rrugës administrative, subjektet e gjobitura kanë të drejtë të ankohen, në rrugë gjyqësore, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Ankimi në rrugë gjyqësore nuk e pengon ekzekutimin e vendimit të gjobës.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 16

Financimi

(Shtuar pika 1/1, togfjalësh në pikën 2 dhe ndryshuar fjalë në pikën 3 me ligjin nr. 110/2024,

datë 31.10.2024)

1. Ministria e Mbrojtjes, në buxhetin e saj, parashikon përballimin e shpenzimeve për Qendrën Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit.
- 1/1. Burimet e financimit të Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit janë:
 - a) buxheti i shtetit;
 - b) fondi për kërkim-shpëtimin, i krijuar në Albcontrol;
 - c) burime dhe donacione të tjera të ligjshme.
2. Ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë, ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe ministria përgjegjëse për mjedisin dhe pyjet parashikojnë në buxhetet e tyre përballimin e shpenzimeve për shërbimin e kërkim-shpëtimit, sipas kompetencave respektive.
3. Shpenzimet e tjera, për angazhimin e strukturave në varësi të ministrisë përgjegjëse për transportin, përballohen në përputhje me dispozitat e nenit 98 të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë.

Neni 17

Nxjerrja e akteve nënligjore

(Shtuar togfjalësh në pikën 1 dhe pika 4 me ligjin nr. 110/2024, datë 31.10.2024)

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4/1, pika 2, 5 pika 2, 6 pika 3, 7 pika 2 dhe 8 të këtij ligji.
2. Ngarkohet Kryeministri të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të pikës 3 të nenit 5 të këtij ligji.
3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të shkronjave “c” dhe “ç” të nenit 9 të këtij ligji.
4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe ministri përgjegjës për transportin të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të pikës 4 të nenit 5 të këtij ligji.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7041, datë 6.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**